

Data 09.08.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirembajtje *“full risk”* e pajisjes mjekesore MRI (resonance magnetike) te prodhuesit Philips/ose ekuivalent, te Spitalit Korce” - Marreveshje kuader me nje operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 2 (dy) vjecar (24 muaj)”.

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Sherbime per riparimin dhe mirembajtjen e pajisjeve mjekesore- 50421000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

Vlera e pritshme e kontratave qe mund te lidhen gjate gjithe periudhes se marrveshjes kuader; 13,612,621.92 (trembedhjete million e gjashteqind e dymbedhjete mije e gjashteqind e njezet e nje pike nentehjete e dy) leke pa TVSH, ose **16,335,146.30** (gjashtembedhjete million e treqind e tridhjete e pese mije e njeqind e dyzet e gjashte pike tridhjete) leke me TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtorja e Sherbimit Spitalor Korce, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas **Shtojcës 1;**
- b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas **Shtojcës 2;**
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 9**
- d. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3;**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (3 viteve fundit nga data e hapjes së ofertave të tenderit) 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit që konkuron. Per kete operatori ekonomik duket te dorezoje vertetim leshuar nga Dega e tatim Taksave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Fondi limit është **13,612,621.92** leke pa TVSH,
40% e 13,612,621.92 = 5,445,048.77 leke pa TVSH.

Pra vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar (2020-2021-2022) duhet të jetë jo më e vogël se **5,445,048.77** leke pa TVSH.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar *Ligji Nr . 9920, datë 19.5.2008 Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise i ndryshuar, Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 Per tatimkin mbi te ardhurat si dhe Udhezimi Nr.5, datë 30.01.2006 Per Tatimin mbi te ardhurat i ndryshuar pika 3.12 “Deklarimi tatimor dhe Llogaritja perfundimtare e detyrimit”.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit që konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Fondi limit është **13,612,621.92** leke pa TVSH,
40% e 13,612,621.92 = 5,445,048.77 leke pa TVSH.

Pra vlera për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të jetë në një vlerë jo më të vogël se **5,445,048.77** leke pa TVSH.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 1(një) Inxhinier/Specialist në stafin e vet të trajnuar për pajisjen mjekësore objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, çertifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore.

Për këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- Diploma.
- CV-në e specialistit/ve;
- Çertifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjen objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre çertifikimeve lëshuar nga autoritetet të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre,;
- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme.
- Listëpagesa ku të figurojë emri i inxhinierit të deklaruar për periudhën **Janar - Korrik 2023.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e AK që OE duhet të ketë të punësuar pjesë të stafit të tij, minimumi 1(një) Inxhinier/Specialist, është vendosur në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysh proceset përkatëse të shërbimit.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Një deklaratë që merr përsipër kryerjen e mirëmbajtjes të tipit Full Risk sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe specifikimeve teknike.

2.4.2. Një deklaratë që merr përsipër zëvendësimin e pjesëve të këmbimit dhe konsumit, që ato do jenë të reja dhe origjinale dhe në përputhje me ato të përdorura fillimisht (të garantuara nepermjet certifikimit CE ose FDA) dhe që përfshihen në vlerën e kontratës dhe se garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

2.4.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese e pajisjeve që do të mirëmbaje ose nga Distributori të Autorizuar, ku në rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për këtë procedurë prokurimi për ofrimin e shërbimit të ofruar.

2.4.4. Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015/ose/ ekuivalent, objekti i së cilës t'i përkasë fushës së aktivitetit të OE. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.4.5. Një deklaratë që pranon oraret e kryerjes së shërbimeve dhe shpejtësinë e ndërhyrjeve.

2.4.6. Planin e veprimeve të mirëmbajtjes parandaluese që ofertuesi do të ndërmarrë, për secilin grup pajisjesh, ku të përcaktohen periodiciteti, procedurat operative dhe protokollet që do të përdorë përfshirë kalibrimet dhe testimet periodike të sigurisë elektrike dhe mekanike të pajisjeve në përputhje me standartet përkatëse evropiane.

Argumentimi; Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ...”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

I. Specifikimet Teknike/Termat E Referencës:

Specifikimet Teknike të Përgjithshme

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga prodhuesi (MAF) / ose Autorizim nga Distributori i Autorizuar (DAF) (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të

- pajisjes mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi të jetë i vlefshëm. Autorizimi duhet të jetë original i përkthyer dhe/ose fotokopje e noterizuar.
2. Operatori Ekonomik duhet të ketë më shumë se një person kontakti për raportimin e defekteve dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëje me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe email).
 3. Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve.
 4. Stafii (i të Kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambientet e Kontraktuesit dhe të shoqerohet nga stafii i ynë.
 5. Ofertuesi (Operatori Ekonomik) duhet të lëshojë një Deklaratë me anë të së cilës merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në ambientet e Spitalit Rajonal Korçë, dhe kjo e fundit nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura të punonjësve të Operatorit Ekonomik në ambientet e tij.

Mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjes mjekësore

1. Mirëmbajtja parandaluese apo preventive të pajisjes mjekësore duhet të kryhet në përputhje me rekomandimet e prodhuesit përkatës për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e tyre dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetërimi apo përkeqësimi i performancës.
2. Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 1(një) Inxhinier/Specialist në stafin e vet të trajnuar për pajisjen mjekësore objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, certifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore.
3. Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë Rekomandimet nga prodhuesi i pajisjes dhe një plan veprimesh të mirëmbajtjes parandaluese që përcakton periodicitetin, procedurat operative dhe protokollet që synon të përdorë, përfshirë kalibrimet.
4. Me lidhjen e kontratës duhet kryer për pajisjen mirëmbajtja preventive, sipas planit të paraqitur. Operatori Ekonomik (OE) duhet të planifikojë dhe koordinojë mirëmbajtjen preventive në bashkëpunim me stafin tonë dhe përdoruesin (stafin mjekësor), dhe ta kryejë jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i kontratës.
5. Pavarësisht planit të parashikuar të mirëmbajtjes preventive, OE duhet të kryejë kontroll periodik mujor të funksionimit të pajisjes.
6. Në përfundim të çdo kontrolli apo mirëmbajtjeje preventive të kryer, duhet të mbahet një raport për faktin. Raporti duhet të jetë i firmosur nga përfaqësuesi i Shërbimit ku ndodhet pajisja, përfaqësuesi ynë dhe Inxhinieri/Tekniku i OE i cili do të kryejë kontrollin/mirëmbajtjen. Modeli i këtij raporti është i standartizuar nga AK.
7. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë kontrole apo verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta dhe Kontraktuesi është i detyruar të pranojë këto kërkesa pa kushte.

Mirëmbajtja korigjuese e Pajisjeve mjekësore

1. Ndërhyrjet e mirëmbajtjes korigjuese konsistojnë në përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionimi, në identifikimin e shkaqeve, eliminimin e tyre dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, për garantimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe sigurisë së saj.
2. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes, riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjese të mundshëm gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesorëve të cilat janë të lidhura me të, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit mjekësor sic mund të jenë: Dedektorë, Kompjuterë, Hard Drive, DVD-CD, Keyboard, Monitor, RAM, Ups, Bllok ushqimi, printer, infrastrukture rrjeti, fisha, sonda, mansheta, sensorë, elektroda, Ingranazhe, pjesë elektronike, elektrike, mekanike, hidraulike, valvula, pjesë mekanike, rrota, pistonë, motorrë etj, dhe ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjes brenda standarteve të përcaktuara nga prodhuesi.
3. Pjesët e demtuara të këmimit, pas zëvendësimit me të reja, do të merren nga subjekti kontraktues.
4. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të paraqitet për të kontrolluar e verifikuar defektin brenda 24 orëve nga marrja e njoftimeve (me e-mail dhe/ose telefon të të dhënat e kontaktit të paraqitur) nga Sektori i Inxhinierisë Klinike për mosfunksionimin normal, probleme të ndryshme apo defekte të pajisjes.
5. Në rastin kur nuk nevojiten pjesë këmbimi, korigjimi i defektit duhet të realizohet jo më vonë se 48 orë pas marrjes së njoftimit.
6. Në rast se konstatohet se për korigjimin e një defekti nevojiten pjesë këmbimi, OE duhet të furnizojë dhe të vendosë pjesët e këmbimit, të riparojë defektin dhe të vendosë pajisjen në gjendje normale pune brenda 7 ditëve kalendarike nga data e hartimit të procesverbalit, të standartizuar nga AK, për nevojën e pjesëve të këmbimit të firmosur nga specialisti ynë, Stafi mjekësor përdorues i pajisjes dhe inxhinieri i Shoqërisë së kontraktuar (OE).
7. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të garantojë që nuk do të jkalojë afatin prej 10 ditësh për vendosjen në funksion të pajisjes.
8. Pas riparimeve apo ndërhyrjeve të kryera, shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë kalibrimet e nevojshme, verifikimin e parametrave sikurse e rekomandon prodhuesi, për garantimin e funksionimit normal të pajisjes.
9. Pas çdo riparimi, zëvendësimi pjesësh këmbimi apo aksesorësh, pajisja duhet të rivendoset në gjendje të plotë pune.
10. Lëvizja, spostimi, çmontimi dhe rimontimi i pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes korigjuese është në ngarkim dhe përgjegjësi të të Kontraktuarit.

11. Pas çdo riparimi apo zëvendësimi të pjesëve duhet të mbahet një procesverbal (i standartizuar nga AK) apo Raport Servisi, formati i të cilit miratohet dhe unifikohet nga AK, që përshkruan në mënyrë të detajuar dhe të qartë defektin/problemin, pjesët e zëvendësuara në qoftë se ka, kalibrimet dhe provën e funksionit. Raporti i Servisit duhet të firmoset nga Shefi i Shërbimit ku ndodhet pajisja ose persona të autorizuar prej tij (staf mjekësor përdorues i pajisjes), specialisti i ynë dhe tekniku apo inxhinieri i shoqërisë së kontraktuar për mirëmbajtjen.
12. Shoqëria e kontraktuar do mundësojë vetëm një herë lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Furnizimi me pjesë këmbimi dhe aksesore

1. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale ose nga prodhues të tjerë të certifikuar, dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, duke siguruar konformitetet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen.
2. Të jenë të certifikuar me CE ose FDA sipas standarteve dhe direktivave të aprovuara në tregun European.
3. Kur është e aplikueshme, pjesët e këmbimit dhe aksesoret duhet të kenë manual instalimi shoqëruar sipas rekomandimeve të prodhuesit. Një kopje e këtij manuali i dorëzohet përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor.
4. Pjesët duhet të kenë jo më pak se 1 (një)* vit garanci ku të përfshihen të gjitha defektet e mundshme të tyre.

(Sqarim: Afati i garancisë së pjesëve të këmbimit mund të tejkalojë afatin e kësaj kontrate. I kontraktuari detyrohet të mirëmbajë, sipas kushteve të garancisë, pjesën e këmbimit edhe pas afatit të përfundimit të kësaj kontrate nëse defekti i pjesës ndodh brenda afatit një vjeçar të garancisë së pjesës së këmbimit/ ose arritjen e maksimumit të konsumit të vërtetuar nga prodhuesi.)

Inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore

Operatori Ekonomik duhet të kryejë të paktën 1(një) inspektim sigurie sipas standartit ndërkombëtar elektrik IEC 62353 të specifikuar nga Direktiva e Pajisjeve Mjekësore MDD (ose MDR) 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, për pajisjen mjekësore dhe pjesëve përbërëse të saj gjatë periudhës së kësaj kontrate, nëpërmjet stafit të trajnuar dhe certifikuar, kur kjo është e zbatueshme.

1. Operatori Ekonomik duhet të kryejë inspektim vizual, testime dhe matje me aparatura të kalibruara.

2. Operatori Ekonomik duhet të planifikojë kryerjen e këtyre testimeve në bashkëpunim me stafin tonë bazuar në specifikimet e prodhuesit.
3. Në përfundim të çdo inspektimi sigurie duhet të përpilohet një raport përshkrues dhe firmoset nga specialistët tanë/Tekniku i kompanisë (OE) që kryen testin.
4. Pas çdo testimi sigurie në pajisje duhet vendosur një shenjë treguese e gjendjes së sigurisë së pajisjes.
5. Përveç rasteve të sipërpërmendura, shërbimi i inspektimit e verifikimit të sigurisë duhet të kryhet edhe pas mirëmbajtjes korigjuese, kur është e zbatueshme.
6. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta dhe Kontraktuesi është i detyruar të pranojë këto kërkesa pa kushte.

Argumentimi: Specifikimet teknike të mësipërme janë përcaktuar përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, pika 3/a të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- **Argumentim:** Në bazë të nenit të 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion kerkesat e cilesise për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Mirembajtje **“full risk”** e pajisjes mjekesore MRI (resonance magnetike) te prodhuesit Philips/ose ekuivalent, te Spitalit Korçe” - Marreveshje kuader me nje operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 2 (dy) vjecar (24 muaj)”.

Emri Pajisjes	Aksesorët	Model	Nr. serisë	Prodhuesi	Viti i prodhimit	Sasia
Rezonance manjetike (MRI)	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi i MRI 2. Anestezia Kompatibël MRI 3. Monitor Pacienti MRI Kompatibël 4. Injektor Kontrasti MRI Kompatibël 5. Set Laringoskopesh (4 cope) 6. Chiller 7. UPS+Kabinet baterish 8. Kabina e Faradeit 9. Workstation 10. Bobinat (Coils)(9 copë) 	INGENIA 1.5T	R201WWW08215386	Philips Healthcare	Janar 2021	1

Afatet e ekzekutimit: Shërbimi i mirëmbajtjes do të kryhet nga lidhja e kontratës brenda MK me afat 24 muaj nga marrëveshja kuadër. Shërbimi do të ofrohet sipas Mini - Kontratave të lidhura brenda MK.

Detyrat: Mirëmbajtja e plotë e pajisjes do të thotë se duhet të kryejë mirëmbajtjen parandaluese/preventive sikurse e cilëson prodhuesi, mirëmbajtjen korrigjuese të secilës pajisje dhe pjesëve përbërëse për çdo defekt të mundshëm pa përjashtuar pjesë specifike, inspektimin e sigurisë elektrike të pajisjeve mjekësore, furnizim dhe ndërrimin e pjesëve të këmbimit dhe aksesoreve si dhe transferimin dhe instalimin me kërkesë nga Autoriteti Kontraktues.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Pranë Korpusit Kryesor të Bllokut Spitalor të Spitalit Rajonal Korçë.

Shënim: AK gëzon të drejtën të përjashtojë nga mirëmbajtja, një apo disa pajisje objekt shërbimi në këtë procedure prokurimi, në rast se pajisja del end-of-support, dhe OE do ta pranojë pa pasoja për AK.

Kontratat do të jepen brenda periudhës, nga momenti i lidhjes së MK me OE fitues, me afat përfundimtar, 24 muaj ose 731 nga lidhja e MK.

Kontratat do të lidhen, me zëra të veçantë, bazuar në periudhën e garancisë dhe periudhën e mbulimit “Full Risk” nga prodhuesi.

Kontratat do të lidhen, me kërkesën e Sektorit të IT dhe Inxhinierisë Klinike, bazuar në periudhën e mbulimit të shërbimit, për çdo ditë kalendarike, brenda periudhës së Marrëveshjes Kuadër.

Njesia e Prokurimit

- | | | |
|-----------|------------|----------------------------------|
| 1. Bledar | HOXHALLARI | anetar (pergjegjes i prokurimit) |
| 2. Albert | PURA | anetar (specialist i fushes) |
| 3. Edmond | RËMAÇKA | anetar |